

Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010, Prishtinë), nenin 85, paragrafi 1, të Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr. 11/11 maj 2012, Prishtinë), si dhe nenin 66, paragrafi 2, të Ligjit nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 18 / 15 qershor 2016, Prishtinë), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 janar 2020, miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT**

### **KAPITULLI I**

#### **Dispozitat e përgjithshme**

##### **Neni 1**

##### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Kjo Rregullore përcakton kriteret dhe procedurat e nevojshme për menaxhimin e procesit të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit në pajtueshmëri me Ligjin nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit.
2. Kjo Rregullore zbatohet për të gjitha bankat, degët e bankave të huaja, institucionet mikrofinanciare, institucionet financiare jobankare dhe siguruesit (më tutje të referura si institucione financiare).

##### **Neni 2**

##### **Përkufizimet**

1. Të gjithë termat e përdorura në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë me termet e përkufizuara në nenin 2 të Ligjit 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit (në tekstin e mëtejme - Ligji për PPP/LFT) dhe / ose me përkufizimet në vijim për qëllimin e kësaj rregulloreje:
  - 1.1 **Menaxher i Lartë** – nënkupton siç është përcaktuar në Ligjin nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare
  - 1.2 **Shërbimet financiare**- nënkupton aktivitetet financiare siç janë përcaktuar në Ligjin nr. 04/L- 093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare ( më tutje Ligji për bankat), Ligjin Nr.05L/045 për Sigurimet dhe siç përshkruhen në përkufizimin e “institucionit financiar” në Ligjin për PPP/LFT.

- 1.3 **NJIF-K** - Njësia për Inteligjencë Financiare e Republikës së Kosovës
- 1.4 **Përfituesi** – nënkupton personin fizik ose juridik ose formë tjetër e organizimit ligjor që identifikohet nga dërguesi si pranues i transferit elektronik.
- 1.5 **Inicues** - nënkupton mbajtësin e llogarisë ose kur nuk ka llogari, personin (fizik ose juridik ose formë tjetër e organizimit ligjor) që urdhëron bankën urdhëruese ose institucionin tjetër financiar, që të ekzekutojnë transferin elektronik ose transferin telegrafik.
- 1.6 **Institucioni financiar urdhërues** - nënkupton bankën ose institucionin tjetër financiar i cili nis një transfer elektronik dhe transferon fondet me marrjen e urdhërit për një transfer elektronik në emër të urdhëruesit (dërguesit-iniciatorit).
- 1.7 **Institucioni financiar ndërmjetësues** – nënkupton bankën ose institucionin tjetër financiar në një varg të vazhdueshëm ose të mbuluar të pagesave që pranon dhe përcjellë një transfer elektronik në emër të bankës ose institucionit financiar urdhërues dhe bankës ose institucionit financiar përfitues ose një bankë ose institucion financiar tjetër ndërmjetësues.
- 1.8 **Institucioni financiar përfitues** - nënkupton bankën ose institucionin tjetër financiar i cili pranon transfere elektronike nga institucioni financiar urdhërues drejtpërdrejt ose nëpërmjet një institucioni financiar ndërmjetësues dhe vë fondet në dispozicion të përfituesit.
- 1.9 **Bankë guaskë** - një bankë ose institucion i angazhuar me aktivitete ekuivalente i themeluar në një shtet ku nuk ka prezencë fizike, e cila bën të mundur menaxhimin dhe drejtimin pa u shoqëruar me ndonjë grup financiar të rregulluar.
- 1.10 **Pagesë përmes llogarisë** - nënkupton llogari korrespondente të cilat, banka respondente ju lejon qasje të drejtpërdrejt klientëve të bankës korrespondente.
- 1.11 **Rezident** – nënkupton një person fizik i cili ka një vendqëndrim kryesor në Kosovë ose fizikisht është i pranishëm në Kosovë mbi njëqind e tetëdhjetë e tre (183) ditë në çdo periudhë kohore dymbëdhjetë (12) mujore.

## **KAPITULLI II**

### **Kërkesat dhe pajtueshmëria me PPP/LFT**

#### **Neni 3**

#### **Përgjegjësitë e institucioneve financiare**

1. Me qëllim të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit (më tutje PPP/LFT) Bordi i Drejtorëve i institucioneve financiare në kuadër të programit për PPP/LFT, duhet të:
  - 1.1 miratojnë politika efektive për PPP/LFT;
  - 1.2 të sigurojnë, që politikat dhe procedurat për PPP/LFT janë zbatuar plotësisht në praktikë;
  - 1.3 emërojnë dhe shkarkoj Udhëheqësin e Funkcionit të PPP/LFT i cili do të marrë përsipër përgjegjësitë e “zyrtarit të pajtueshmërisë “ sipas nenit 21 të Ligjit për PPP/LFT. Në rastin e degëve të institucioneve financiare të huaja, emërimi apo shkarkimi i udhëheqësit të

Funksionit të PPP/LFT do të bëhet nga bordi i drejtorëve të institucionit financiar i cili operon përmes degës në Kosovë, në konsultim me menaxhmentin e lartë të degës në Kosovë.

- 1.4 sigurojë që Funkzioni i brendshëm për PPP/LFT është pajisur teknikisht dhe me personel të cilët kanë njohuri të plotë të politikave dhe procedurave për PPP/LFT, si dhe të posedojnë standarde të larta etike dhe ekspertizë relevante;
  - 1.5 miratojë një politikë për krijimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve të biznesit, veçanërisht ato që përfshijnë rrezik më të lartë, përfshirë personat e ekspozuar politikisht dhe për këtë qëllim të zhvillojnë procedura efektive të ndjeshmërisë së rrezikut për pranimin dhe largimin e klientëve, produkteve dhe shërbimeve;
  - 1.6 përcaktojë politikat e rrezikut lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, përfshirë pranimin dhe menaxhimin e rrezikut;
  - 1.7 miratojë politikën për pranim të klientëve në kuadër të menaxhimit të rrezikut të institucionit;
  - 1.8 marr vendime për çështjet e referuara në fushën e përgjegjësisë së tyre operacionale në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje;
  - 1.9 pranojë dhe diskutojë raportet e auditimit të brendshëm në lidhje me zbatimin e politikave dhe procedurave të PPP/LFT;
  - 1.10 të miratojë masa të tjera të tilla që mund të kërkohen kohë pas kohe, nga institucionet relevante.
2. Menaxhmenti i institucioneve financiare është përgjegjës për:
- 2.1 miratimin e procedurave për zbatimin e politikave për PPP/LFT;
  - 2.2 sigurimin e pajtueshmërisë me procedurat e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit në ato fusha të institucionit për të cilat janë përgjegjës;
  - 2.3 sigurimin e zbatimit efektiv të të gjitha politikave dhe procedurave për PPP/LFT në baza ditore;
  - 2.4 ofroj në kohë të duhur Udhëheqësit të Funkzionit të PPP/LFT, asistencën e duhur, informatat dhe këshillat për raportet e brendshme të aktiviteteve të dyshimta.
3. Të gjithë punonjësit e institucionit financiar duhet të jenë të trajnuar dhe informuar që:
- 3.1 të jenë vigjilent ndaj mundësisë që shërbimet dhe produktet e institucionit mund të përdoren për pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit;
  - 3.2 mënyrën si t'i raportojnë Udhëheqësit të Funkzionit për PPP/LFT të gjitha transaksionet, veprimet apo personat e dyshimtë për pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit dhe transaksionet në vlerën e përcaktuar sipas nenit 26 të Ligjit për PPP/LFT. Në rast të mungesës të Udhëheqësit të Funkzionit për PPP/LFT raportimi duhet të bëhet tek zëvendësi i tij siç përcaktohet në nenin 21 të ligjit për PPP/LFT.
  - 3.3 të zbatojnë në mënyrë efektive procedurat e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit siç janë të përcaktuara me Ligjin mbi PPP/LFT, këtë Rregullore, dhe në politikat dhe procedurat e brendshme të institucionit të tyre në veçanti për kujdesin e duhur të klientëve, monitorimin e vazhdueshëm të transaksioneve dhe ruajtjes së të dhënave; dhe

- 3.4 të marrin pjesë aktive në trajnime dhe sesionet e ndërgjegjësimit të ofruara nga institucioni financiar.
4. Për institucionet financiare të cilat për nga natyra e organizimit të tyre nuk kanë të themeluar Bordin e Drejtorëve, obligimet sipas kësaj Rregulloreje do të përmbushen nga Menaxhmenti.

#### **Neni 4**

##### **Funksioni i brendshëm për PPP/LFT**

1. Institucionet financiare duhet të emërojnë një individ të kualifikuar dhe me përvojë relevante si Udhëheqës të pajtueshmërisë i cili do të veprojë si person përgjegjës i pajtueshmërisë në pajtim me nenin 21 të Ligjit mbi PPP/LFT dhe paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, dhe kjo do të konsiderohet si kriter minimal për pajtueshmëri me këtë rregullore. Institucionet financiare mund të ngritin në një nivel më të lartë në strukturën e tyre organizative Funksionin e pajtueshmërisë për PPP/LFT me kusht që Funksioni të ruajë pavarësinë e tij. Bankat do të themelojnë Funksion të brendshëm për PPP/LFT i cili do të jetë i pavarur nga të gjitha funksionet e tjera në kuadër të bankës dhe duhet të jetë në nivelin e menaxhmentit të lartë dhe t'i raportojë drejtpërdrejt Kryeshefit Ekzekutiv dhe në baza periodike Bordit të Drejtorëve në përputhje me kushtet dhe procedurat e vendosura me këtë Rregullore.
2. Udhëheqësi i Funksionit të brendshëm për PPP/LFT gjatë kryerjes së detyrave të tij duhet të ketë:
  - 2.1 qasje të plotë dhe të pakufizuar në të gjitha të dhënat, shënimet, dokumentacionin dhe informatat e bankës ose të institucionit financiar;
  - 2.2 resurse të nevojshme njerëzore bazuar në madhësinë e institucionit financiar;
  - 2.3 materiale dhe paisje të nevojshme të TI-së dhe hapësirë të duhur punuese të nevojshme dhe përshtatshme për të përmbushur obligimet që dalin nga ligji për PPP/LFT dhe kjo rregullore;
  - 2.4 kushte teknike për një nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave konfidenciale dhe të qasshme për zyrtar të pajtueshmërisë;
  - 2.5 trajnim të vazhdueshëm profesional në fushën për PPP/LFT;
  - 2.6 mbrojtje në lidhje me zbulimin e të dhënave të tyre tek personat e paautorizuar;
3. Nuk mund të jetë udhëheqës i Funksionit të brendshëm për PPP/LFT:
  - 3.1 personi që nuk është person rezident në Kosovë;
  - 3.2 personi që është anëtar i bordit të drejtorëve, drejtor ekzekutiv apo mbanë ndonjë post tjetër të përhershëm në institucionin financiar i cili mund të jetë në konflikt me rolin e tij si udhëheqës i njësisë;
  - 3.3 personi që është punonjës i institucionit financiar, i cili merret me auditimin e brendshëm;
  - 3.4 personi që është punonjës i institucionit financiar që është përgjegjës për kontroll të aktiviteteve dhe monitorimit operacional.
4. Funksioni i Pajtueshmërisë për PPP/LFT tek këmbimoret mund të ushtrohet nga Drejtori i Këmbimores, përveç rasteve kur ky i fundit nuk e përcakton ndonjë person tjetër për ta ushtruar këtë funksion.
5. Për bankat, Udhëheqësi i Funksionit të brendshëm për PPP/LFT do të konsiderohet menaxher i lartë në pajtim me Ligjin për banka.

6. Institucionet financiare duhet ta njoftojnë NjIF-K dhe BQK-në për emërimin e Udhëheqësit të Funkcionit të brendshëm për PPP/LFT sipas afateve ligjore të përcaktuara në paragrafin 8 të nenit 21 të ligjit për PPP/LFT.
7. Me rastin e largimit të Udhëheqësit të Funkcionit të brendshëm për PPP/LFT - institucionet financiare duhet ta njoftojnë NjIF-K dhe BQK-në sipas afateve ligjore të përcaktuara në paragrafin 8 të nenit 21 të ligjit për PPP/LFT duke shpjeguar edhe arsyet e shkarkimit të tij.
8. Funkzioni i brendshëm për PPP/LFT i institucioneve financiare duhet ta këshillojë dhe ndihmojë Bordin e Drejtorëve dhe Menaxhmentin e Lartë në implementimin e legjislacionit në fuqi për PPP/LFT. Ky Funkzion do të jetë koordinator ose përgjegjës, mes tjerash, për:
  - 8.1 përgatitjen e politikave dhe procedurave të brendshme të PPP/LFT sipas nenit 5 të kësaj Rregulloreje për aprovim nga Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti;
  - 8.2 monitorimin e implementimit të politikave dhe procedurave të brendshme të PPP/LFT;
  - 8.3 bashkëpunimin me auditorët e brendshëm, auditorët e jashtëm dhe menaxhmentin për çështjet që lidhen me PPP/LFT;
  - 8.4 planifikimin dhe mbikëqyrjen e trajnimit dhe ndërgjegjësimin të punonjësve të institucionit financiar lidhur me PPP/LFT;
  - 8.5 përcaktimin e kritereve për marrëdhëniet e biznesit duke përfshirë rrezikun e lartë siç është përshkruar në nenin 6 të kësaj Rregulloreje;
  - 8.6 kryerjen, si minimum në baza vjetore të vlerësimit të gjitha rreziqeve që rrjedhin nga klientët ekzistues dhe të ri, produktet e reja dhe shërbimet e ofruara nga institucioni financiar në pajtim me nenin 7 të kësaj Rregulloreje.
  - 8.7 kryerjen e vlerësimit të efektivitetit të procedurave të brendshme duke përdorur informacionin statistikor të mbledhur brenda vendit dhe atyre të mbajtura nga institucionet financiare siç mund të përcaktohen nga NjIF-K apo BQK.
  - 8.8 pranimin e raporteve të brendshme të aktiviteteve të dyshimta dhe të kryejë rishikimin e brendshëm të raporteve të tilla në mënyrë, që të përcaktohet nëse dyshimi është i arsyeshëm dhe nëse rezulton që të jetë, bënë raportim tek NjIF-K sic përcaktohet në nenin 26 të ligjit për PPP/LFT.
  - 8.9 raportimin e informatave tjera në NjIF-K në pajtueshmëri me dispozitat ligjore të Ligjit për PPP/LFT;
  - 8.10 bashkëpunimin në mes bankës ose institucionit financiar dhe autoriteteve përkatëse sipas nenit 26 të ligjit për PPP/LFT në lidhje me aktet e dyshimta ose raportet e transaksioneve të paraqitura në NjIF-K.
  - 8.11 detyra tjera të caktuara nga Bordi i Drejtorëve dhe/ose Menaxhmenti i Lartë për të ndihmuar në parandalimin e përdorimit të bankës për pastrim të parave apo qëllime të financimit të terrorizmit.

## **Neni 5**

### **Politikat dhe procedurat e brendshme të PPP/LFT**

1. Institucionet financiare do të miratojnë politikat dhe procedurat e brendshme për PPP/LFT dhe

komunikojnë ato gjithë stafit përkatës.

2. Politikat dhe procedurat e brendshme sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet së paku të përcaktojnë:
  - 2.1 një politikë për kujdes të duhur të klientëve në pajtim me Ligjin për PPP/LFT dhe këtë Rregullore, duke përfshirë procedurën për identifikimin dhe pranimin të klientit të ri në kuadër të menaxhimit të rrezikut të pranueshëm të institucionit financiar;
  - 2.2 procedurë për grumbullimin dhe ruajtjen e informacionit dhe shënimeve në pajtim me Ligjin mbi PPP/LFT dhe këtë Rregullore;
  - 2.3 procedurë për raportimin në NjIF-K sipas nenit 26 të Ligjit mbi PPP/LFT;
  - 2.4 kriteret që do të zbatohen në identifikimin e marrëdhënieve të biznesit që përfshijnë rrezik më të lartë;
  - 2.5 procedurën për identifikimin dhe trajtimin e personave të ekspozuar politikisht;
  - 2.6 procedurën për vlerësimin e rrezikut dhe monitorimit të rrezikut për klientët, marrëdhëniet e biznesit, produkteve dhe transaksioneve;
  - 2.7 procedurat për zhvillimin nga ana e institucionit financiar të indikatorëve të pastrimit të parave dhe financimin e aktiviteteve terroriste bazuar në rekomandimet e TFVF, udhëzimet e NjIF-K dhe kërkesat e BQK-së;
  - 2.8 situatat në të cilat Funkzioni i brendshëm për PPP/LFT duhet të konsultohet nga stafi dhe rastet në të cilat Bordi i Drejtorëve dhe/ose Menaxhmenti i Lartë duhet të njoftohen për ngjarjet që lidhen me PPP/LFT;
  - 2.9 procedurat për verifikimin, aftësimin dhe trajnimin e stafit për qëllime të PPP/LFT;
3. Institucionet financiare do të hartojnë politikat dhe procedurat e brendshme për mbrojtjen e personelit të pajtueshmërisë dhe personelit tjetër, që kanë të bëjnë me raportimin e transaksioneve të dyshimta.

## **Neni 6**

### **Programi për PPP/LFT**

1. Institucionet financiare do të hartojnë dhe mirëmbajnë një program të PPP/LFT me qasje të bazuar në rrezik.
2. Qëllimi kryesor i programit të PPP/LFT është të identifikojë, zvogëlojë dhe menaxhojë rrezikun që ofrimi i një shërbimi të caktuar nga një institucion financiar mundet me dashje apo pa dashje, të përfshijë ose të lehtësojë pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit.
3. Programi për PPP/LFT duhet të bëjë identifikimin e klientit dhe procedurat për kujdesin e duhur për klientët e institucionit financiar.

## **Neni 7**

### **Analiza e rrezikut të PPP/LFT**

1. Për të arritur në një vendim të bazuar objektivisht për pranimin e klientëve dhe në veçanti ku klientët mund të paraqesin rrezik të lartë për institucionin, institucionet financiare duhet të kenë politikë të hartuar për nivelin e rrezikut i cili duhet të menaxhohet në vazhdimësi. Institucionet

financiare do të krijojnë dhe mirëmbajnë një strategji të “pranimit të rrezikut” i cili duhet të jetë i favorshëm për të ndihmuar në politikat e tyre të pranimit të klientëve.

2. Në përputhje me dispozitat e nenit 18 të Ligjit për PPP/LFT institucionet financiare duhet të përgatitin një analizë të rrezikut dhe hartojnë vlerësimin e rrezikut për klientët, marrëdhëniet e biznesit, produktet ose transaksionet në lidhje me mundësinë e keqpërdorimit të tyre për pastrimin e parave ose financimit të terrorizmit. Institucionet financiare duhet të kuptojnë dhe të pranojnë rreziqet dhe dobësitë që mund ta ekspozojnë vetë institucionin nga keqpërdorimet e mundshme të produkteve dhe shërbimeve të saj.
3. Vlerësimi i rrezikut duhet të marrë në konsideratë elementet e mëposhtëm të rrezikut që janë të pranishme në çdo marrëdhënie biznesi:
  - 3.1 Rreziku i klientit (rreziku që vjen nga lloji i klientit);
  - 3.2 Rreziku i produktit (rreziku që është formuar nga qëllimi i vetë produktit);
  - 3.3 Rreziku i vendit (rreziku i formuar nga maturia gjeografike e aktiviteteve ekonomike të marrëdhënieve të biznesit);
4. Elementet e përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, duhet të kombinohen së bashku për të krijuar një profil të rrezikut. Profili i rrezikut apo procedura për të krijuar profilin e rrezikut duhet të pasqyrojë karakteristikat specifike të organizatës dhe veprimtarisë së saj (p.sh. madhësia e saj dhe përbërja, fushëveprimi dhe struktura e biznesit, llojin e klientëve me të cilët organizata bënë biznes dhe llojet e produkteve të ofruara nga organizata) siç përcaktohet me nenin 12 të kësaj Rregulloreje.
5. Analiza e rrezikut të PPP/LFT do të kryhet në dy faza:
  - 5.1 Vlerësimi i rrezikut bazuar në produkte, shërbime, dhe shpërndarje gjeografike të institucionit financiar në të cilën institucioni ushtron veprimtarin e saj/tij.
  - 5.2 Vlerësimi i rrezikut bazuar në marrëdhënie të klientëve të institucionit financiar dhe produkteve dhe shërbimeve të përdorura nga klientët e tyre aq sa edhe vendëndodhjet gjeografike në të cilat ato banojnë, veprojnë ose bëjnë biznes dhe faktorë të tjerë të ngjashëm të rrezikut.
6. Vlerësimi i rrezikut sipas pikës 5.1 të këtij neni nënkupton njohuri të mirë të operacioneve të biznesit të institucionit dhe ushtrimi i gjykimit të shëndoshë në mënyrë të tillë, që rreziku për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit mund të peshohet (vlerësohet) sipas faktorit individual gjithashtu si kombinim i tyre. Edhe pse mjetet e zhvilluara për analizën e rrezikut kanë qëllim që të sigurojnë objektivitet, një element i subjektivitetit mbetet për përcaktimin e faktorit të rrezikut dhe për këtë arsye sa më i informuar të jetë procesi i vendimmarrjes aq më real është gjykimi i shkallës së rrezikut të faktorit. Elementi i vlerësimit të rrezikut nuk është statik dhe do të ndryshojë me kalimin e kohës, ashtu sikurse ndryshon mënyra se si institucionet financiare operojnë, zhvillimet e produkteve dhe shërbimeve të tyre të ofruara.
7. Vlerësimi i rrezikut sipas pikës 5.2 të këtij neni nënkupton vlerësimin e marrëdhënieve bazuar në rrezik i cili ndjek një metodologji që më në fund arrin të identifikojë nivelin e rrezikut që vjen nga një klient i veçantë dhe në këtë mënyrë mundëson që institucionet financiare të përcaktojnë nëse pranimi i këtij klienti të ri do të mund të paraqes rrezik që mund të jetë i dëmshëm.
8. Institucionet financiare duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë rreziqet e pastrimit të parave ose të financimit të terrorizmit që mund të lindin në lidhje me:

- 8.1 zhvillimin e produkteve të reja dhe praktikave të reja të biznesit, duke përfshirë mekanizmat e ri të shpërndarjes, dhe
  - 8.2 përdorimin e teknologjive të reja apo në zhvillim, edhe për produktet e reja edhe për ato para-ekzistuese.
9. Një vlerësim i tillë i rrezikut duhet të bëhet para futjes në përdorim të produkteve të reja, praktikave të biznesit apo përdorimit të teknologjive të reja ose në zhvillim. Ato duhet të marrin masat e duhura për të administruar dhe për të zvogëluar këto rreziqe.

## **Neni 8**

### **Kujdesi i duhur ndaj klientit**

1. Programi për PPP/LFT përcakton procedurat e zbatueshme të identifikimit të klientëve dhe kujdesit të duhur ndaj klientëve të institucioneve financiare. Institucionet financiare duhet të ushtrojnë kujdesin e duhur ndaj klientëve për:
  - 1.1 Klientët;
  - 1.2 Çdo pronar përfitues të klientit;
  - 1.3 Çdo person që vepron në emër të një klienti.
2. Për qëllime të kësaj Rregulloreje dhe në bazë të nenit 19 të Ligjit për PPP/LFT dhe në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare, kujdesi i duhur ndaj klientit është i përbërë nga, por nuk kufizohet në:
  - 2.1 Identifikimin dhe verifikimin e identitetit të klientit në bazë të dokumenteve të vlefshme të lëshuara nga autoritetet kompetente;
  - 2.2 Përcaktimin e pronarit përfitues dhe marrjen e masave të duhura të bazuara në rrezik për të verifikuar identitetin e tij/ saj;
  - 2.3 Sigurimin e informacionit mbi qëllimin dhe natyrën e marrëdhënieve të biznesit dhe krijimin e një profili të klientëve në bazë të informacioneve të grumbulluara;
  - 2.4 Zbatimin e kujdesit të duhur dhe monitorimit të vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit dhe transaksioneve të klientëve në përputhje me profilin e klientit;
  - 2.5 Implementimin e politikave dhe praktikave të përshkruara për transferet elektronike ose transferet telegrafike dhe bankat korrespondente; dhe
  - 2.6 Regjistrimin dhe ruajtjen e të dhënave.

## **Neni 9**

### **Identifikimi, verifikimi dhe pranimi i klientëve të ri**

1. Institucionet financiare do të sigurojnë që ata e njohin identitetin e vërtetë të klientit dhe kanë njohuri të plotë të biznesit të klientit para se ata të vendosin marrëdhënie biznesi, në bazë të detyrimeve të nenit 19 të Ligjit për PPP/LFT. Përveç kësaj, para se të krijojnë një marrëdhënie



biznesi me një klient, institucionet financiare duhet t'i referohen listës ndërkombëtare të përditësuar të personave të kërkuar për financim të terrorizmit si pjesë e ndërmarrjes së një vlerësimi bazuar në marrëdhënie ose vlerësimi të klientëve të bazuar në rrezik në përputhje me nenin 7 të kësaj Rregulloreje.

2. Institucionet financiare do të marrin hapa shtesë që të sigurojnë identifikimin e duhur të klientëve kur lindin dyshimet për vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave të identifikimit të marra më parë ose kur ekziston dyshimi, që klienti është, ose mund të jetë i përfshirë në pastrim parash apo financim të terrorizmit.
3. Institucionet financiare do të verifikojnë të dhënat e identifikimit me burim të pavarur siç është specifikuar në nenin 19 të Ligjit për PPP/LFT. Procesi i verifikimit është i ndarë por komplementar me procesin e identifikimit. Përveç kërkesave të nenit 19 të Ligjit për PPP/LFT, institucionet financiare mund të kërkojnë dhe marrin cilindo dokumentacion shtesë të identifikimit për qëllim të verifikimit ashtu siç ata e konsiderojnë të arsyeshme dhe të duhur për rrethanat e secilit rast në mënyrë që procesi i kujdesit të duhur të përfundohet në mënyrë të kënaqshme.
4. Përveç kërkesave të nenit 19 të Ligjit për PPP/LFT për verifikimin e identitetit të klientëve të cilët janë persona fizikë, institucionet financiare duhet të përdorin dokumente të besueshme, dokumente me burim të pavarur, të dhëna ose informacione, të tilla siç janë letërnjoftimi, pasaporta, patent shoferi apo certifikata e lindjes me fotografi. Identifikimi i personave fizik dhe verifikimi i identitetit të tyre duhet të përfshijë emrin e plotë, adresën, datën dhe vendin e lindjes.
5. Përveç kërkesave të përcaktuara me nenin 19 të Ligjit për PPP/LFT në procesin e marrjes dhe verifikimit të informacioneve të identifikimit të personave juridik, institucionet financiare duhet të përdorin dokumentet që dëshmojnë:
  - 5.1 emrin e klientit dhe formën ligjore, duke përfshirë dëshminë e themelimit apo ndonjë dëshmi të ngjashme të themelimit ose ekzistencës ( të tilla si një certifikatë e inkomporimit ose një certifikatë të themelimit të trustit);
  - 5.2 emrat dhe adresat e anëtarëve të organit kontrollues të klientëve, si për drejtorët e kompanive, administratorët e trusteve, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, ortakëritë e përgjithshme dhe drejtuesit e lartë të tillë si drejtor i përgjithshëm ekzekutiv;
  - 5.3 dokumentet që përcaktojnë statusin e klientit ( të tilla si memorandumit dhe statuti ose certifikata e themelimit të trustit)
  - 5.4 dokumentet që autorizojnë personat të veprojnë në emër të klientit (të tilla si vendimi i Bordit të Drejtorëve ose deklarata e administratorit në hapjen e një llogarie dhe dhënien e autoritetit atyre që mund të operojnë në llogari );
  - 5.5 identiteti i personit fizik që pretendon të veprojë në emër të klientit,
6. Në rast se klienti është përfaqësuar nga një person i tretë nëpërmjet një akti përfaqësimi, banka ose institucioni financiar duhet të kërkojë të dhëna për identifikimin e klientit dhe përfaqësuesit të tij dhe të mbajë dosjen e klientit e të gjitha dokumenteve të paraqitura nga personi i tretë, duke përfshirë origjinalin ose kopjen e autorizimit të noterizuar.
7. Në rastet kur klienti nuk është “prezent fizikisht” duhet të merren masat adekuate siç janë

përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 22 të Ligjit për PPP/LFT. Megjithatë marrëdhëniet e biznesit pa “praninë fizike” duhet të jenë vetëm si raste përjashtuese dhe jo të rregullta dhe se masat shtesë në bazë të procesit paraprak të kujdesit të duhur të klientëve të respektohen në mënyrë rigorozë.

8. Në rrethanat kur në kushtet e paragrafit 7 të këtij neni të kësaj Rregulloreje institucionet financiare krijojnë marrëdhënie ose ndërmarrin një transaksion pa praninë fizike të klientit bankat dhe institucionet financiare duhet të aplikojnë masa të kujdesit të duhur të shtuar siç kërkohet në nenin 22 të Ligjit të PPP/LFT e cila marrëdhënie detyrueshëm konsiderohet si situatë me rrezikshmëri të lartë. Në këto raste duhet të sigurohet që kërkesa për pagesën e parë të funksionimit të llogarisë të bëhet nga një llogari bankare e hapur në emrin e klientit nga një bankë e vendit të origjinës.
9. Institucionet financiare nuk do të krijojnë një marrëdhënie biznesi, të hapin llogari ose të ndërmarrin transaksione në emër të një klienti të mundshëm deri në përfundimin adekuat të identifikimit të plotë dhe procesit të verifikimit. Në rastet kur një bankë ose institucion financiar nuk është në gjendje të përmbush pikat 2.1, 2.2 dhe 2.3 të nenit 8 të kësaj Rregulloreje në përputhje me Kapitullin III të Ligjit për PPP/LFT, institucioni financiar, do të refuzojë transaksionin ose marrëdhënien e biznesit dhe do të konsideroj paraqitjen e një raporti të transaksionit të dyshimtë në NjIF-K në përputhje me procedurat e përcaktuara të raportimit.
10. Institucionet financiare duhet të zhvillojnë politika dhe procedura të qarta të pranimit të klientëve brenda menaxhimit të tyre të rrezikut dhe si pjesë integrale të qasjes së tyre të bazuar në rrezik. Politikat dhe procedurat e tilla të pranimit të klientëve duhet të përfshijnë një përshkrim të llojeve të klientëve, që mund të përbëjnë një rrezik më të lartë se mesatarja në një institucion financiar në mënyrë që, masa të shtuara të kujdesit të duhur mund të zbatohen ndaj klientëve me rrezik më të lartë. Faktorë të tillë si e kaluara e klientit, vendi i origjinës, pozita publike apo e profilit të lartë, llogaritë e lidhura, aktivitetet biznesore dhe tregues të tjerë të rreziqeve duhet të merren parasysh.
11. Klientët të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara me Ligjin për PPP/LFT dhe këtë Rregullore mund të hapin një llogari ose të bëjnë biznes me institucionin financiar. Një person fizik apo juridik që nuk i plotëson kriteret të përcaktuara me politikën dhe procedurat e pranimit të klientëve nuk do të lejohet të hapë një llogari ose të ndërmarrë çfarëdo transaksioni.

## **Neni 10**

### **Përcaktimi i mbajtësve të së drejtës së pronësisë (pronarëve përfitues)**

1. Ligji mbi PPP/LFT përcakton pronarin përfitues si “personin fizik i cili përfundimisht zotëron ose kontrollon një klient ose një llogari, një person në emër të cilit transaksioni është duke u kryer ose një person i cili përfundimisht ushtron kontroll efektiv mbi një person juridik ose marrëveshje”- neni 2 paragrafi (1) pika (1.36). Neni 19 paragrafi (1) pika (1.2) i Ligjit mbi PPP/LFT përcakton se “të gjitha subjektet raportuese duhet të identifikojnë pronarin përfitues dhe/ose personin fizik ose personat të cilët drejtpërdrejtë ose në mënyrë indirekte kontrollojnë 25% ose më shumë të një personi juridik”.
2. Institucionet financiare do të marrin masa për të përcaktuar nëse një klient është duke vepruar në emër të një ose më shumë pronar(ve) përfitues në pajtim me Kapitullin III të Ligjit mbi PPP/LFT. Për të identifikuar dhe verifikuar identitetin e klientit dhe të pronar(ve) përfitues institucionet financiare do të veprojnë sipas nenit 19 të Ligjit për PPP/LFT dhe nenit 9 të kësaj Rregulloreje.

Institucionet financiare do të verifikojnë të dhënat informacionet e identifikimit të dokumentacioneve me burim të pavarur siç është specifikuar në nenin 19 të Ligjit për PPP/LFT.

3. Institucionet financiare do të sigurojnë, që një person i cili vepron në emër të një personi tjetër është i autorizuar dhe do të mbajë një kopje të dokumentit të ofruar të autorizimit të tillë.
4. Për klientët të cilët janë subjekte (persona juridik), siç përcaktohet në Ligjin për PPP/LFT, institucionet financiare duhet të marrin masa të konsiderueshme, që të zbulojnë pronarët dhe strukturën e kontrollit të subjektit. Institucionet financiare do të identifikojnë “vendimmarrësit dhe menaxhmentin” e personit juridik dhe përfundimisht (personin fizik) pronarët përfitues të cilët, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi, kontrollojnë 25% ose më shumë të personit juridik. Duke identifikuar pronarin(ët) përfitues bankat dhe institucionet financiare do të përcaktojnë nëpërmjet procedurave të tyre të vlerësimit të rrezikut të klientëve nëse pronari(ët) i/e tillë përfitues përkon me status të personit të ekspozuar politikisht në pajtim me kushtet e Ligjit për PPP/LFT. Në raste të tilla bankat dhe institucionet të tjera financiare duhet të zbatojnë masat e zgjeruara për personat e ekspozuar politikisht siç parashihet nga Ligji për PPP/LFT dhe kjo Rregullore.
5. Për qëllim të kësaj Rregulloreje, “një person do të konsiderohet si ushtrues drejtëpërdrejt ose tërthorazi i kontrollit në personin juridik në ndonjë nga situatat e mëposhtme:
  - 5.1 nëpërmjet mbajtjes të 25% ose më shumë të kapitalit aksionar të personit juridik të regjistruar në emër të atij personi;
  - 5.2 nëpërmjet mbajtjes të 25% ose më shumë e të drejtës së votimit në personin juridik pavarësisht nga mbajtja e aksioneve;
  - 5.3 kur, duke vepruar në bashkëpunim me persona të tjerë, ai person ushtron kontroll përmes mbajtjes prej 25% ose më shumë të kapitalit aksionar ose të drejtave të votës;
  - 5.4 nëpërmjet mbajtjes së 25% ose më shumë të kapitalit aksionar të personit juridik të regjistruar në emër të një personi tjetër juridik i cili përfundimisht është në pronësi nga ai person;
  - 5.5 nëpërmjet mbajtjes së 25% ose më shumë të të drejtave të votës të një personi juridik nga një person tjetër juridik i cili përfundimisht është në pronësi nga ai person.
6. Për subjektet që janë organizata joprofitabile/OJQ institucionet - financiare do të sigurohen që të identifikojnë strukturën e kontrollit dhe të kuptojnë qëllimin legjitim të organizatës, duke shikuar statutin e saj, themelimin ose dokumentin e mirëbesimit.
7. Për marrëveshjet e tjera ligjore të tilla si trustet, përtej identifikimit të administruesit, përmbaruesit dhe/ose drejtorit, institucionet financiare do të identifikojnë përfituesit e trustit të 25% ose më shumë të pasurisë, ku përfituesit kanë qenë të përcaktuar ose kur përfituesit nuk kanë qenë të përcaktuar, klasifikimi i personave në interes të cilit është ngritur ose vepron marrëveshja ligjore. Për lloje tjera të marrëveshjeve ligjore institucionet financiare do të identifikojnë personat me pozitë ekuivalente ose të ngjashme.

## **Neni 11**

### **Krijimi i profilit të klientit**

1. Institucionet financiare duhet të mbledhin informacione, në mënyrë të vazhdueshme, në lidhje

me qëllimin e parashikuar dhe natyrën e synuar të marrëdhënies së biznesit. Dokumentet, të dhënat ose informacioni i mbledhur në bazë të procesit të hulumtimit të kujdesit të duhur ndaj klientit do të mbahen deri në datën përkatëse dhe duke ndërmarrë shqyrtime periodike të të dhënave ekzistuese, duke përfshirë të dhënat e transaksioneve.

- Institucionet financiare duhet të krijojnë dhe mirëmbajnë një profil të klientëve për çdo klient, me detaje të mjaftueshme për t'i mundësuar bankës ose institucionit financiar të monitorojë transaksionet e klientit, t'i kushtojë kujdes të duhur klientit kur është e nevojshme dhe të zbulojnë transaksionet/aktet e dyshimta siç kërkohet nga Kapitulli III të Ligjit mbi PPP/LFT dhe kjo Rregullore. Të dhënat dhe informacionet e përfshira në profil duhet të jetë në përputhje me nivelin e rrezikut që pritet të paraqitet nga ana e klientit.
- Profili i klientit do të përfshijë informacionin përkatës për veprime normale dhe të arsyeshme për lloje të ndryshme të klientëve duke marrë parasysh natyrën e biznesit të klientit, si dhe një kuptim të plotë të transaksioneve të klientit (duke përfshirë sipas nevojës burimin dhe legjitimitetin e fondeve) dhe marrëdhëniet e përgjithshme me bankën ose institucionin financiar.

## Neni 12

### Monitorimi i marrëdhënieve biznesore dhe transaksioneve

- Institucionet financiare duhet t'i kushtojnë vazhdimisht kujdes të duhur marrëdhënieve të biznesit dhe t'i shqyrtojnë transaksionet e kryera gjatë gjithë rrjedhës së marrëdhënies, për të siguruar që transaksionet e kryera janë në përputhje me njohuritë e institucionit financiar për klientin dhe profilin e tyre të biznesit dhe rrezikut. Për këtë qëllim, përpos kërkesave të nenit 19 të ligjit për PPP/LFT, në rrethanat kur institucionet financiare e shohin të nevojshme duhet të kërkohet informacioni për të konfirmuar burimin e fondeve. Institucionet financiare duhet të kenë sisteme për të zbuluar transaksionet e mëdha ose komplekse të kryera (përfunduara) jashtë pritshmërive (njohurive) për atë lloj të klientit.
- Institucionet financiare duhet të kryejnë monitorime të (intensifikuara) shpeshta për klientët me rrezik të lartë. Çdo institucion financiar duhet të përcaktojë treguesit kryesorë për llogaritë e tilla duke marrë parasysh të kaluarën e klientit, vendi prej nga vjen dhe burimet e fondeve, tipi i transaksioneve të përfshira dhe faktorëve tjerë të rrezikut siç është përcaktuar në Ligjin për PPP/LFT dhe këtë Rregullore.
- Strukturimi i procesit të vazhdueshëm të monitorimit të llogarive, transaksioneve dhe identifikimit të klientëve dhe të informacionit për profilin e tyre do të paraqitet sipas tabelës si më poshtë.

Kategoria e rrezikut	Frekuenca minimale e monitorimit
3.E Lartë	Transaksionet: <i>Ditore</i> Llogaria: <i>Mujore</i> Informata e klientit: <i>Vjetore</i>
2. E Mesme	Transaksionet: <i>Javore</i> Llogaria: <i>Gjashtëmujore</i> Informata e klientit: <i>Trevjeçare</i>
1. E Ulët	Transaksionet: <i>Mujore</i> Llogaria: <i>Vjetore</i> Informata e klientit: <i>Pesëvjeçare</i>

4. Frekuenca kohore e monitorimit sipas tabelës në paragrafin 3 të këtij neni, nuk do të aplikohet kur ka dyshime për pastrim të parave ose financim të terrorizmit ose kur banka ose institucioni financiar identifikon ndryshime të mëdha në transaksione bazuar në profilin e rrezikut të klientit.

### **Neni 13**

#### **Transferet elektronike**

1. Institucionet financiare duhet të marrin dhe të mbajnë informacion të plotë të inicuesit (autorit) të transfereve elektronike dhe të verifikojnë, që informacioni është i saktë dhe kuptimplotë.
2. Informacioni sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të përmbajë së paku:
  - 2.1 emrin e inicuesit;
  - 2.2 numrin e llogarisë së inicuesit ose një numër unik reference nëse nuk e ka numrin e llogarisë;
  - 2.3 adresën, numrin personal të identifikimit të inicuesit, datën dhe vendin e lindjes.
  - 2.4 emrin e përfituesit;
  - 2.5 numri i llogarisë së përfituesit ku llogaria e tillë është përdorur për të procesuar transaksionin.
3. Institucionet financiare duhet të përfshijnë informacion të plotë të inicuesit në mesazh ose në formën e pagesës, që shoqëron transferin dhe kur veprojnë si ndërmjetës në një varg të pagesave, ato do të mbajnë informacionin e plotë të inicuesit me transferin dhe do ta transmetojnë atë.
4. Në rastin e transfereve të brendshme elektronike është e mjaftueshme për institucionin financiar urdhërues, të përfshijë vetëm numrin e llogarisë të iniciatorit ose kur nuk ekziston një numër i llogarisë një numër identifikues unik, së bashku me mesazhin ose formën e pagesës, duke siguruar se informacioni i plotë i iniciatorit mund të vihet në dispozicion të bankës ose institucionit tjetër financiar përfitues edhe për NjIF-K ose BQK-në.
5. Institucionet financiare përfituese duhet të kenë procedura për ndjeshmëri të rrezikut për të identifikuar dhe vëzhguar transferet elektronike, që nuk janë të shoqëruara me informacion të plotë të inicuesit. Procedurat për trajtimin e këtyre rasteve duhet të përcaktojnë formën/mënyrën që institucioni financiar të kërkojë informacionin e munguar për inicuesin nga institucioni financiar që ka përcjellë (dërguar) transferin elektronik.
6. Nëse informacioni i munguar nuk vëhet në dispozicion, banka kërkuese ose institucioni tjetër financiar duhet të vlerësoj dhe përcaktoj nëse në këto rrethana, mungesa e informacionit të plotë për inicuesin krijon apo kontribuon në dyshimin në lidhje me transferin. Nëse transferi konsiderohet të jetë i dyshimtë, duhet të raportohet nga banka ose institucioni tjetër financiar përfitues në NjIF-K në përputhje me procedurat e raportimit. Përveç kësaj, procedurat e ndjeshme të rrezikut të bankës ose të institucionit tjetër financiar mund të çojnë institucionin për të vendosur mos të pranojë transferin.
7. Në rrethana të përshtatshme, të tilla si dy ose më shumë transaksione me informacione jo të plota ose të munguara nga inicuesi, institucioni financiar përfitues duhet të marrë parasysh kufizimin ose ndërprerjen e marrëdhënieve të biznesit me institucionin financiar që nuk është në përputhje

me kërkesat e këtij neni.

8. Institucionet financiare urdhëruese duhet të mbajnë shënime me informacion të plotë të inicuesit, e cila e shoqëron transferimin e fondeve për një periudhë prej pesë (5) viteve, në përputhje me Ligjin për PPP/LFT dhe nenin 17 të kësaj Rregulloreje.
9. Institucionet financiare përfituese duhet të mbajnë shënime të informatave të marra nga iniciatori i cili e shoqëron transferin e fondeve për një periudhë prej pesë (5) viteve, në përputhje me Ligjin për PPP/LFT dhe nenin 19 të kësaj Rregulloreje.
10. Institucioni financiar ndërmjetësues duhet të mbajë shënime për të gjitha informatat të cilat shoqërojnë transferimin e fondeve për një periudhë prej pesë (5) viteve, në përputhje me Ligjin për PPP/LFT dhe nenin 17 të kësaj Rregulloreje.
11. Ligji për PPP/LFT parashikon që detyrimet për informacionet mbi iniciatorin (autorin) nuk kanë për qëllim të mbulojnë:
  - 11.1 çdo transfer që rrjedh nga një transaksion i kryer duke përdorur një kartë krediti ose debitit për aq kohë sa numri i kartës së kreditit ose kartës së debitit i shoqëron të gjitha transferet që rrjedhin nga transaksioni;
  - 11.2 çdo transferim dhe marrëveshje në mes të bankave dhe institucioneve financiare, ku që të dy autori dhe përfituesi janë banka apo institucione financiare që veprojnë në emër të tyre.
  - 11.3 kur kartat e kreditit apo debitit janë përdorur si sistem të pagesave për të mundësuar transferin, ato janë të mbuluara nga Ligji për PPP/LFT dhe kjo Rregullore, si dhe informacioni i domosdoshëm duhet të përfshihet në mesazh.

## **Neni 14**

### **Marrëdhëniet korrespondente**

1. Neni 22 i Ligjit për PPP/LFT kërkon ngritjen e masave të detyrueshme krahas masave standarde për të zgjeruar kujdesin e duhur në marrëdhëniet korrespondente bankare, që përfaqësojnë një rrezik më të lartë për bankat. Bankat, do të zhvillojnë dhe të zbatojnë politikat dhe procedurat në lidhje me bankat korrespondente dhe të cilat adresojnë rreziqe të larta në marrëdhënie të tilla.
2. Për qëllim të këtij neni, bankimi korrespondent është i definuar si mjet për ofrimin e shërbimeve bankare nga një bankë (korrespondente) në një bankë tjetër (respondente), që mund të përfshijnë kredi, depozita, mbledhjen, kliringun apo shërbime pagesash. Bankat në Kosovë do të veprojnë si "banka respondente", kur ata krijojnë marrëdhëniet për pranimin e shërbimeve bankare nga një bankë tjetër (banka korrespondente) ose si "bankat korrespondente", kur ata krijojnë marrëdhëniet për ofrimin e shërbimeve bankare në një bankë tjetër (banka respondente).
3. Bankat duhet të ushtrojnë maturi dhe kujdes të duhur në lidhje me kontrollet potenciale të bankës korrespondente kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe të përcaktojnë sesa janë këto kontrolle adekuate dhe efektive dhe duhet të dokumentojnë përgjegjësitë përkatëse të PPP/LFT të secilit institucion. Bankat nuk duhet të ndërmarrin marrëdhënie biznesi me bankat guaskë ndërsa me bankat korrespondente nga vendet që paraqesin rrezik të lartë të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit banka duhet të sigurohet që mund të aplikojë masa të zgjeruara për të zvogëluar rreziqet e tilla, siç kërkohet në nenin 18 të kësaj Rregulloreje.
4. Për të vlerësuar kontrollet e bankës potenciale respondente kundër pastrimit të parave dhe

financimit të terrorizmit në bazë të kërkesave të paragrafit 3 të këtij neni, banka duhet të mbledhë informata të mjaftueshme për bankën potenciale respondente për të kuptuar biznesin e tyre dhe për të përcaktuar nga informacione publike në dispozicion për reputacionin e institucionit, cilësinë e mbikëqyrjes dhe nëse ajo ka qenë subjekt i hetimit për pastrim të parave ose financim të terrorizmit ose veprimeve rregullatore. Banka në përgjithësi duhet të krijojë ose të vazhdojë një marrëdhënie korrespondente me një bankë të huaj respondente vetëm nëse është e bindur se një autoritet është duke e mbikëqyrur bankën respondent në mënyrë efektive. Në veçanti, një bankë nuk duhet të krijojë ose të vazhdojë një marrëdhënie korrespondente bankare me një bankë guacë siç përcaktohet në Ligjin për PPP/LFT .

5. Kujdes i veçantë duhet të ushtrohet kur bankat respondente lejojnë përdorimin e drejtpërdrejtë të llogarisë korrespondente nga palët e treta për të bërë biznes në emër të tyre ( pagesë përmes llogarive). Banka duhet të jetë e bindur se banka respondente ka kryer procesin e kujdesit të duhur për ata klientë të cilët kanë qasje të drejtpërdrejtë në llogaritë e bankës respondente dhe se banka respondente është në gjendje të sigurojë informacione relevante të identifikimit të klientit me kërkesë të bankës korrespondente.
6. Bankat duhet të zhvillojnë dhe zbatojnë politikat dhe procedurat lidhur me monitorime të vazhdueshme të aktiviteteve të kryera nëpërmjet llogarive korresponduese. Banka duhet të marrë miratimin nga menaxhmenti i lartë para se të krijojë marrëdhënie të reja korrespondente dhe duhet të zbatojë masat e zgjeruara për kujdes të duhur të parashikuar në paragrafin (4) të nenit 22 të Ligjit për PPP/LFT.

## **Neni 15**

### **Personat e ekspozuar politikisht**

1. Neni 22 i Ligjit për PPP/LFT dhe udhëzimet e lëshuara nga NjIF-K kërkojnë zbatimin e masave të arsyeshme nga institucionet financiare, për të përcaktuar nëse klientët e tyre janë persona të ekspozuar politikisht vendas apo të huaj. Institucionet financiare duhet të sigurojnë që të zbatojnë masa të duhura në situata të tilla, duke përfshirë kur një pronar përfitues është identifikuar si person, që ka statusin e personit të ekspozuar politikisht.
2. Kur një person identifikohet si person i ekspozuar politikisht vendas ose i huaj me rastin e krijimit të marrëdhënieve afariste, bankat dhe institucionet të tjera financiare do të ndërmarrin masat e përcaktuara në paragrafin 5.1 të nenit 22 të Ligjit për PPP/LFT.
3. Institucionet financiare do të zbatojnë masat e kujdesit të duhur të shtuar për marrëdhëniet e vazhdueshme me një klient ekzistues apo pronarin përfitues i cili është identifikuar të jetë një person i ekspozuar politikisht.
4. Në ndërmarrjen e masave të arsyeshme për të njohur origjinën e aseteve të përdorura në marrëdhënien ose transaksionin në përputhje me paragrafin 5 të nenit 22 të Ligjit për PPP/LFT, institucionet financiare duhet të sigurojnë, që masa të tilla do të përfshijnë shqyrtimin e burimit të pasurisë dhe burimin e fondeve të klientit.
5. Për qëllim të paragrafit 4 këtij neni, "burim i pasurisë" i referohet aseteve që klienti posedon dhe mund të jenë akumuluar gjatë viteve, ndërsa " burimi i fondeve " i referohet fondeve, që do të aplikohen për transaksionet e para dhe në vijim, të ndërmarra nga ana e klientit në statusin e tij si një person i ekspozuar politikisht.

6. Institucionet financiare duhet të sigurojnë se "anëtarët e familjes së ngushtë" dhe "personat të njohur si bashkëpunëtorë të ngushtë" të personit të ekspozuar politikisht vendas dhe të huaj do të jenë subjekt i masave të njëjta të kujdesit të duhur të shtuar.
7. Procedurat dhe masat për përcaktimin se kush është person i ekspozuar politikisht mund të përfshijnë, duke mos u kufizuar në:
  - 7.1 kërkimin e informatave përkatëse nga klienti potencial duke iu referuar paragrafit 4 të këtij neni;
  - 7.2 kërkimin në listat zyrtare vendore dhe ndërkombëtare;
  - 7.3 referimin në informacionin publik në dispozicion; dhe
  - 7.4 qasje në bazat e të dhënave komerciale elektronike potenciale për persona të ekspozuar politikisht.

## **Neni 16**

### **Mbajtja e të dhënave dhe ruajtja e tyre**

1. Institucionet financiare duhet të mbajnë të gjitha të dhënat e nevojshme të transaksioneve, që të dyja si vendore dhe ndërkombëtare, për të paktën pesë (5) vite pas përfundimit të transaksionit ose përfundimit të transaksionit të fundit në një seri transaksionesh të ndërlidhura (ose më gjatë nëse kërkohet nga NjIF-K, BQK-ja ose organi tjetër kompetent në raste të veçanta). Kjo kërkesë zbatohet pavarësisht nëse marrëdhënia e biznesit është duke vazhduar ose është ndërprerë.
2. Të dhënat për transaksionet duhet të jenë të mjaftueshme për të lejuar rindërtimin e transaksioneve individuale në atë mënyrë që të ofrojnë, nëse është e nevojshme, dëshmi për ndjekjen e aktivitetit kriminal. Të dhënat e transaksioneve të tilla përfshijnë:
  - 2.1 emrin e klientit dhe pronarit përfitues, (dhe mbajtësit të autorizimit, nëse është e aplikueshme) adresat e tyre ose informatat tjera identifikuese të regjistruara si zakonisht nga banka;
  - 2.2 natyrën (llojin) dhe datën e transaksionit;
  - 2.3 lloji dhe sasia e valutës të përfshirë në transaksion; dhe
  - 2.4 llojin dhe numrin e identifikimit të llogarive të përfshira në transaksion.
3. Institucionet financiare duhet të mbajnë të gjitha të dhënat e nevojshme në lidhje me klientin, pronarin përfitues ose mbajtësit të autorizimit, skedarët (fajllat) e llogarive dhe korrespondencave të biznesit për së paku pesë (5) vite pas përfundimit të marrëdhënieve të biznesit, ose në raste të veçanta për një periudhë më të gjatë, nëse është kërkuar nga NjIF-K, BQK-ja ose autoriteti tjetër kompetent. Të dhënat duhet të identifikojnë anëtarin e stafit të cilët kanë bërë identifikimin e klientit (dhe pronarit përfitues nëse është e aplikueshme). Institucionet financiare do të sigurojnë masa mbrojtëse për të mbrojtur të dhënat nga dëmtimi dhe për të parandaluar qasjen e paautorizuar.
4. Institucionet financiare duhet të mbajnë raportet e të gjeturave të analizës së transaksioneve të mëdha komplekse dhe të marrëdhënieve të biznesit, që janë subjekt i monitorimit të veçantë siç është përcaktuar në nenin 25 të Ligjit për PPP/LFT. Raportet e gjetjeve do të mbahen minimum për një periudhë prej pesë (5) viteve nga përfundimi i analizës apo më gjatë nëse kërkohet nga



NjIF-K apo BQK-ja.

5. Në mungesë të një marrëdhënie të vazhdueshme të biznesit, institucionet financiare dhe në veçanti zyrat e këmbimit të valutave dhe operatorët e transferevetë parave, do të mbajnë kopjet e identifikimit të të dhënave dhe të dhënat e transaksioneve për një periudhë prej pesë
6. (5) vitesh pas një transaksioni të rastit apo transaksionit të fundit në një seri transaksionesh të rastit të ndërlidhura.
7. Institucionet financiare do të vënë në dispozicion nëse kërkohet nga, NjIF-K, BQK-ja dhe çdo autoriteti tjetër kompetent të gjitha të dhënat dhe informatat në dispozicion për një klient, pronarin përfitues ose mbajtësit të autorizimit dhe të gjitha të dhënat e kërkuara të transaksionit, në formën dhe mënyrën e plotë, me kohë dhe të kuptueshme.
8. Nëse institucionet financiare janë në dijeni përsa i përket të dhënave, që lidhen me hetimet në vazhdim, të dhënat e tilla duhet të mbahen deri sa të konfirmohet nga agjencia përkatëse e zbatimit të ligjit që rasti është mbyllur, edhe nëse ka kaluar afati prej 5 viteve.
9. Të dhënat elektronike të institucioneve financiare duhet të jenë të ruajtura në kopje (backup) në mënyrë elektronike dhe duhet të jenë në dispozicion në formë të lexueshme për NjIF-K, BQK-në dhe autoritetet kompetente sipas legjislacionit në fuqi.
10. Grumbullimi, përpunimi dhe përdorimi dhe ruajtja e të dhënave personale nga bankat dhe institucionet financiare kufizohet në atë që është e domosdoshme për qëllimin e veprimit në përputhshmëri me kërkesat e ligjit për PPP/LFT dhe të dhënat personale nuk duhet të përpunohen më tutje në mënyrë të papajtueshme me këtë qëllim. Në veçanti, përpunimi i mëtejshëm i të dhënave personale për qëllime komerciale ndalohet.

## **Neni 17**

### **Kujdesi i duhur ndaj klientit**

1. Duke marrë parasysh nivelin e rrezikut, institucionet financiare, do të zhvillojnë kujdes të duhur ose kujdes të duhur të shtuar ndaj klientëve.
2. Institucionet financiare duhet të zhvillojnë kujdes të duhur ndaj klientëve në përputhje me termat dhe kushtet e parashtruara në rrethanat e mëposhtme, por pa u kufizuar në:
  - 2.1 gjatë krijimit të një marrëdhënie biznesi me një klient të ri;
  - 2.2 kur në lidhje me një klient ekzistues ka pasur një ndryshim material në natyrën ose qëllimin e marrëdhënieve të biznesit, duke konsideruar që ka informacion të pamjaftueshëm në lidhje me klientin;
  - 2.3 kur ka dyshime për vërtetësinë dhe saktësinë e informatave të klientit ose pronarit përfitues, të marra paraprakisht;
  - 2.4 kur realizohet një transaksion në para të gatshme që arrin shumën 10,000 euro ose më tepër ose vlerën ekuivalente në valutë të huaj, nëse transaksioni është kryer në një operacion të vetëm ose në disa veprime (transaksione) të cilat janë të lidhura në mënyrë të dukshme dhe të kryera në një ditë të vetme;
  - 2.5 gjatë kryerjes së një transaksioni që është transfer elektronik qoftë vendor apo ndërkombëtar;

2.6 kurdo që ka një dyshim për pastrim parash ose financim të terrorizmit.

## Neni 18

### Kujdesi i duhur i shtuar ndaj klientit

1. Në zbatimin e kujdesit të duhur të shtuar, institucionet financiare duhet të kujdesen, që të mos angazhohen në diskriminim të paligjshëm në bazë të racës, ngjyrës, fesë apo përkatësisë kombëtare.
2. Në vijim me zbatimin e masave të detyrueshme të kujdesit të duhur të shtuar në përputhje me nenin 14 dhe nenin 15 të kësaj rregulloreje, institucionet financiare do të kryejnë kujdes të duhur të shtuar ndaj klientëve, krahas masave standarde, në përputhje me termat dhe kushtet e parashikuara nga kjo Rregullore në rrethanat e mëposhtme, por pa u kufizuar:
  - 2.1 gjatë krijimit të një marrëdhënie biznesi me një klient që është një trust apo një tjetër mjet (fond) për mbajtjen e asetëve personale dhe një klient jorezident.
  - 2.2 në çdo fazë të procesit të kujdesit të duhur ndaj klientëve, marrëdhëniet të biznesit ose transaksioneve ku institucionet financiare në pajtim me nenin 7 të kësaj rregulloreje kanë vlerësuar se këto kategori janë me rrezik më të lartë për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Në këtë proces institucionet financiare duhet të bëjnë përpjekje për shqyrtimin e burimit të pasurisë, dhe burimit të fondeve të klientit;
  - 2.3 në marrëdhëniet e biznesit dhe transaksioneve me personat fizikë dhe juridikë, duke përfshirë institucionet financiare, nga vendet të cilat paraqesin rreziqe më të larta të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Për këtë qëllim institucionet financiare duhet të marrin parasysh deklaratat dhe listat publike të nxjerra nga Task Forca e Veprimit Financiar (FATF) për juridiksione me rrezik të lartë dhe ato jobashkëpunuese.
3. Institucionet financiare do të zbatojnë masa të shtuara në monitorimin e llogarive, transaksioneve dhe marrëdhëniet të biznesit dhe ngrisin elementin e rrezikut në situata të tilla ku si rezultat i dyshimit për pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit është dërguar raport në NjIF-K.
4. Institucionet financiare duhet të marrin miratimin e një menaxheri të lartë të subjektit raportues për të krijuar apo për të vazhduar marrëdhënien e biznesit, me një klient të rrezikut më të lartë.
5. Masat e kujdesit të duhur të shtuar ndaj klientëve, që institucionet financiare mund t'i aplikojnë dhe përfshijnë por pa u kufizuar në:
  - 5.1 informacionin shtesë të identifikimit dhe dokumentet për verifikimin e identitetit të klientit dhe të pronarit përfitues sipas nevojës;
  - 5.2 informacionin shtesë dhe sqarimi mbi burimin e pasurisë dhe burimin e fondeve;
  - 5.3 marrjen dhe vlerësimin e informacionit shtesë mbi natyrën e synuar të marrëdhëniet të biznesit;
  - 5.4 të kuptuarit më të mirë për arsyet e një transaksioni të synuar ose të kryer nëpërmjet marrjes së informacionit shtesë;
  - 5.5 rritjen e monitorimit dhe shqyrtimit të marrëdhëniet të biznesit, transaksioneve dhe llogarive duke përfshirë burimin e fondeve;
  - 5.6 rritjen e frekuencës për përditësimin e informacionit në dispozicion për identifikimin e

klitentit, nivelit të rrezikut dhe profilit të biznesit;

5.7 rritjen e raportimit periodik menaxhmentit të lartë.

6. Për subjektet që janë organizata joqeveritare/joprofitabile, duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut, institucionet financiare mund t'i aplikojnë dhe përfshijnë këto masa të kujdesit të duhur të shtuar ndaj klientëve, por pa u kufizuar në:

6.1 identifikimin e themeluesve përmes dokumenteve zyrtare;

6.2 identifikimin e strukturës drejtuese, bordit të drejtorëve dhe manxhmentit ekzekutiv;

6.3 informatat mbi donatorët kryesor të organizatës joprofitabile/OJQ;

6.4 raporte vjetore të aktiviteteve financiare, projekteve të realizuara dhe atyre të planifikuara.

## **Neni 19**

### **Identifikimi dhe raportimi i veprimtarive të dyshimta dhe transaksioneve**

1. Disa lloje të transaksioneve duhet të sinjalizojnë institucionet financiare për mundësinë, që klienti është duke kryer aktivitete dhe veprime të dyshimta. Ato mund të përfshijnë transaksionet që nuk kanë qëllim të qartë ekonomik, të ligjshëm ose komercial apo që përfshijnë sasi të mëdha të lëvizjeve të mjeteve monetare, që nuk janë në përputhje me transaksionet normale dhe të pritshme të klientit në përputhje me profilin e rrezikut dhe biznesit për atë klient. Qarkullimi shumë i lartë i llogarisë, në mospërputhje me sasinë e fondeve që mbahen normalisht në llogari, mund të tregojnë se fondet po pastrohen. Shembuj të aktiviteteve të dyshimta bankare të veçanta mund të jenë shumë të dobishme për institucionet financiare dhe duhet të përfshihen në aktivitetet e trajnimit. Një akt ose transaksion i dyshimtë zakonisht do të jetë ai aktivitet që është në kundërshtim me njohuritë e aktiviteteve të biznesit ligjor ose aktiviteteve personale të klientit ose me biznesin normal të klientit për atë lloj të produktit financiar.

2. Pyetjet që një bankë ose institucion tjetër financiar mund t'i marrë parasysh kur përcaktohet nëse një veprim ose transaksion mund të jetë i dyshimtë janë:

2.1 A është madhësia e transaksionit në përputhje me aktivitetet normale të klientit?

2.2 A është transaksioni racional në kontekstin e aktiviteteve të biznesit ose aktiviteteve personale të klientit?

2.3 A është ndryshuar modeli i transaksioneve të realizuara nga ana e klientit?

2.4 Kur transaksioni është i natyrës ndërkombëtare, a ka klienti ndonjë arsye të dukshme për kryerjen e biznesit me vendin tjetër të përfshirë?

3. Institucionet financiare duhet të marrin parasysh se fakti që një klient tregon një preferencë për të kryer një transaksion në të gatshme nën kufijtë e vlerës 10,000 euro mund të presupozohet se ka për qëllim shmangien e raportimit dhe si i tillë krijon apo kontribuon në dyshim për transaksionin. Institucionet financiare duhet të marrin në konsideratë që transaksionet e shumëfishta, që janë kryer në para të gatshme nga ose në emër të një personi ose entiteti dhe që duket të jetë i lidhur dhe që shuma e përgjithshme është 10,000 euro ose më shumë, gjatë një periudhe kohore krijon apo kontribuon në dyshim në lidhje me transaksionet.

4. Institucionet financiare duhet të ofrojnë udhëzime dhe trajnime të mjaftueshme për stafin për t'i mundësuar atyre, që të njohin veprimet dhe transaksione të dyshimta. Ato duhet të sigurojnë, që

të gjithë punonjësit e dinë se cilit person në institucion financiar duhet t'i raportojnë dyshimet dhe se ka një linjë të qartë të raportimit, ku këto dyshime do të dërgohen në Funksionin e PPP/LFT. Linja e raportimit ndërmjet personit që ka ngritur dyshimin dhe Funksionit për PPP/LFT duhet të jetë sa më e shkurtër.

5. Funksioni i pajtueshmërisë PPP/LFT duhet të konfirmojë marrjen e raportit nga anëtari i stafit dhe në të njëjtën kohë të ofrojë udhëzimin dhe t'i përkujtoj për obligimet që të mos marrin ndonjë veprim që mund të dëmtojë hetimet që d.m.th., paralajmërimin për dyshimin shpjeguar sipas nenit 26 të Ligjit për PPP/LFT dhe siç kërkohet në paragrafin 12 të këtij neni.
6. Pasi Funksioni për PPP/LFT ka pranuar këtë raport fillestar, ajo do të kontrollojë dhe do të analizojë çështjen në bazë të informacionit të brendshëm. Institucionet financiare duhet të ruajnë të dhënat e analizave dhe rezultateve të tilla. Nëse, gjatë shqyrtimit të analizave dhe rezultateve, banka ose institucioni financiar arrin në përfundim se veprimet apo transaksionet ose veprimet e tentuara apo transaksionet japin bazë të arsyeshme për të dyshuar për pastrim parash ose kur gjendet një lidhje me akt ose transaksion të financimit të terrorizmit, Funksioni për PPP/LFT do të raportojë aktin ose transaksionin ose aktin ose transaksionin e tentuar menjëherë në NjIF-K. Institucionet financiare do t'i raportojnë NjIF-K situatat kur informacioni në dispozicion tregon se një person ose entitet mund të jetë ose mund të ketë qenë i përfshirë në -pastrim të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe/apo financim të terrorizmit.
7. Të gjitha kërkesat e brendshme të krijuara në lidhje me raportin dhe arsyet për të vendosur nëse do të dorëzohet raporti ose jo në NjIF-K, duhet dokumentuar. Regjistrat e dyshimeve të cilat janë ngritur përbrenda strukturës së PPP/LFT, por jo të dërguara në NjIF-K gjithashtu duhet të ruhen për pesë (5) vite, nga data e kryerjes së transaksionit.
8. Në bazë të nenit 26 të Ligjit për PPP/LFT institucionet financiare duhet të raportojnë tek NjIF të gjitha aktet ose transaksionet e dyshimta brenda 24 orëve nga koha kur aktiviteti ose transaksioni është identifikuar si i dyshimtë. Informatat e mjaftueshme të cilat krijojnë dyshim të arsyeshëm për tu raportuar duhet të shpalosen dhe në qoftë se një vepër e veçantë dyshohet, kjo duhet të deklarohet. Kur institucioni financiar ka prova të tjera relevante, që mund të vihen në dispozicion, natyra e kësaj dëshmie duhet të tregohet në mënyrë të qartë kur raportohet, pa vonesë në NjIF-K.
9. Kur një institucion financiar raporton në pajtim me paragrafin 1.2 të nenit 26 të Ligjit për PPP/LFT, por ka dyshime se transaksioni mund të përfshijë pastrim parash ose mund të ketë lidhje me financimin e terrorizmit, ato gjithashtu duhet të paraqesin një raport të transaksionit të dyshimt lidhur me atë transaksion në NjIF-K në pajtim me paragrafin 6 të këtij neni, që tregon se dy raportet i referohen të njëjtit transaksion, aktit ose personit.
10. Nëse një institucion financiar vendos të mos hyjë në një marrëdhënie biznesi për shkak të dyshimit për pastrim parash ose financimit të terrorizmit, vendimin e tillë do ta raportoj menjëherë në NjIF-K siç përcaktohet me ligjin për PPP/LFT.
11. Institucionet financiare do të raportojnë në NjIF-K çdo klient apo transaksion, në bazë të të cilave ata kanë arsye për të dyshuar që mund të jenë të lidhur me financimin e terrorizmit ose me individët të cilët e mbështesin terrorizmin. Kujdes duhet t'i kushtohet monitorimit dhe mbajtjes së listës së përditësuar të organizatave dhe individëve në lidhje me terroristët apo terrorizmin në bazë të informacionit të marrë nga NjIF-K ose burime të tjera ndërkombëtare në dispozicion. Kujdes duhet t'i kushtohet organizatave jofitimprurëse dhe humanitare, veçanërisht në qoftë se

aktivitetet nuk janë në përputhje me veprimtarinë e regjistruar, nëse burimi i fondeve nuk është i qartë, ose nëse organizatat e tilla pranojnë pasuritë nga burime të dyshimta.

12. Subjektet raportuese, drejtorët, zyrtarët, punonjësit e përkohshëm apo të përhershëm të subjektit raportues të cilët përgatisin apo transmetojnë raporte në pajtim me këtë ligj, nuk zbulojnë fakte për raportin që është dorëzuar ose është në proces për t'u dorëzuar, nuk e sigurojnë këtë raport, as nuk e komunikojnë ndonjë të dhënë të përfshirë në atë raport apo për atë raport, përfshirë kur një informacion i tillë është duke u përgatitur për t'u raportuar, apo kur hetimet për pastrim parash ose financim të terrorizmit janë duke ose mund të kryhen, asnjë personi apo subjekti, përfshirë çdo person apo subjekt të përfshirë në transaksionin i cili përfshihet në raport, përveç NjIF-K, pa pasur autorizim me shkrim nga NjIF-K, prokurori publik ose gjykata.
13. Është përgjegjësi e çdo zyrtari ose punonjësi të një banke ose institucioni tjetër financiar, i cili e ka ngritur i pari dyshimin mbi një akt ose transaksion ose person i cili ka qenë i përfshirë ose ka lidhje me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit për të siguruar, që një raport i brendshëm i dyshimit të tillë është paraqitur tek Udhëheqësi i Funkcionit për PPP/LFT. Sipas Ligjit për PPP/LFT çdo lloj kërcënimi për t'i nxitur ata, që të përmbahen nga krijimi i një raporti ose për të bërë një deklaratë të rreme ose të dështojnë të deklarojnë informacionin e vërtetë në NjIF-K, ose agjenci të tjera hetimore ose autoritetet gjyqësore është një vepër e ndëshkueshme në bazë të Ligjit për PPP/LFT. Në raste të tilla zyrtarët raportues ose punonjësit duhet të raportojnë menjëherë çështjen në përputhje me linjat e tyre të brendshme të raportimit dhe procedurat e institucionit.

## **Neni 20**

### **Verifikimi, aftësimi dhe trajnimi i stafit**

1. Institucionet financiare duhet ta vënë në dijeni stafin për detyrimet e tyre personale ligjore (statutore) dhe t'i informojnë ata, që do të jenë personalisht përgjegjës nëse dështojnë për të raportuar informacionin në përputhje me politikat dhe procedurat e brendshme.
2. Institucionet financiare do të zbatojnë masa të përgjithshme për të siguruar që punonjësit e tyre, sidomos stafi që ka kontakt me klientët ose ekzekutimin e transaksioneve dhe stafin brenda funksionit për PPP/LFT, nuk kanë një të kaluar kriminale ose nuk janë objekt i një ndjekje të vazhdueshme penale për krime financiare, terrorizmi ose ndonjë krim tjetër serioz që mund ta vë në dyshim besueshmërinë e tyre.
3. Institucionet financiare do të sigurojnë rregullisht, të paktën një herë në vit, trajnime mbi PPP/LFT për të gjithë stafin që kanë kontakt me klientët ose ekzekutimin e transaksioneve.
4. Dokumentet mbi strukturën e programeve të trajnimit, përmbajtjes së tyre, emrat dhe nënshkrimet e pjesëmarrësve duhet të mbahen në dosje të bankës ose institucionit financiar për së paku pesë (5) vite.

## **Neni 21**

### **Roli i auditimit të brendshëm dhe të jashtëm**

1. Departamenti i auditimit të brendshëm të institucioneve financiare duhet të kryejë auditim së paku një herë në vit për të siguruar, që politikat dhe procedurat për PPP/LFT janë zbatuar plotësisht dhe në përputhje me të gjitha kërkesat e Ligjit për PPP/LFT dhe këtë Rregullore.

Departamenti i Auditimit të Brendshëm duhet t'i raportojë çdo vit Bordit të Drejtorëve dhe informoj menaxhmentin e institucioneve financiare mbi të gjeturat dhe vlerësimet e tij, duke përfshirë një vlerësim të përshtatshëm të trajnimit të stafit për çështjet e PPP/LFT.

2. BQK-ja mund të kërkojë që institucionet financiare të angazhojnë auditorët e tyre të jashtëm për të vlerësuar dhe raportuar mbi kualitetin e masave për implementimin e PPP/LFT duke përfshirë zbatimin e kërkesave ligjore dhe rregullative, zbatimim e politikave dhe procedurave, sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe kryerjen e auditimit të brendshëm.

### **Kapitulli III**

#### **Neni 22**

#### **Mbikëqyrja nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës**

1. BQK-ja do të mbikëqyrë institucionet financiare në aspektin e pajtueshmërisë me detyrimet sipas Ligjit për PPP/LFT dhe kësaj Rregulloreje.
2. BQK-ja do të mbikëqyrë dhe inspektoj institucionet financiare. Për këtë qëllim BQK-ja do të zbatojë këto kompetenca mbikëqyrëse për të drejtën e hyrjes, të drejtën për të kërkuar informacionet dhe dokumentet dhe për të marrë kopjet e nevojshme dhe të drejtat e ngjashme të dhëna sipas Ligjit PPP/LFT dhe legjislacionit relevant për institucionet financiare.

#### **Neni 23**

#### **Masat përmirësuese**

Shkeljet e dispozitave të Ligjit për PPP/LFT dhe kësaj Rregullore do jenë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese siç përcaktohet me Ligjin për PPP/LFT, Ligjin për Bankën Qendrore dhe Legjislacionin përkatës për institucionet financiare.

#### **Neni 24**

#### **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore me 24 nëntor 2016 dhe çdo dispozitë tjetër që mund të jetë në kundërshtim me këtë Rregullore të lëshuar nga BQK.

#### **Neni 25**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit nga Bordi i BQK-së.

Flamur Mrasori

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës